



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-051

**PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË
USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK**

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË
USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit ndërmjet interesit publikë dhe interesit privatë të zyrtareve të lartë në ushtrimin e funksionit publik .

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, subjekteve, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve ndërmjet konfliktit të interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit të lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Interes publik** - besimi dhe pritja e publikut për sa i përket vendimmarrjes së paanshme dhe të drejtë të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksionit publik.

1.2. **Interes privat** - interesi privat pasuror ose personal jo pasuror i zyrtarit të lartë që mund të ndikojnë në vullnetin e tij në vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik.

1.3. **Konflikt i interesit** - konflikti i interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit të lartë në kuptim të nenit 6 të këtij ligji.

1.4. **Person i afërt me zyrtarin** – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton , të afërmit në vije të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vije të tërthortë deri në shkallën e katërt, adaptuesi, i adaptuari, në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.

1.5. **Person i besueshëm**”- personi që ka ose ka pasur mardhenje pasurore ose biznesi me zyrtarin e lartë, apo raporte tjera që do të vente në dyshim vendimmarrjen e paanshme të zyrtarit publik.

1.6. **Zotërimi aktiv i aksioneve ose pjesëve në kapital** - ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital

1.7. **Zotërimi pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital** - gjendja në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve të pronësisë, por nuk mund të ushtroj vet asnjë veprim tjetër mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet tjera si administrimi, zotërim, kryhen nga personi i besuar nga pronari.

1.8. **Konflikti rast për rast i interesave private të zyrtarit** - gjendje me konflikt interesi që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.

1.9. **Agjencion** – Nënkupton Agjencionin Kundër Korrupsionit.

Neni 4

Zyrtar i lartë publik

1. Zyrtar i lartë në kuptim të këtij ligji, janë këta ushtrues të funksionit publik:

1.1. Presidentin e Republikës së Kosovës, anëtarët e kabinetit të Presidentit, Sekretarin si dhe Drejtorët e Departamenteve në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

1.2. Deputetët e Kuvendit, si dhe të gjithë personat e zgjedhur apo te emëruar nga Kuvendi apo kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

1.3. Kryeministri, Zëvendës Kryeministrat, Ministrat, Zëvendës Ministrat, Këshilltarët politik Shefat e kabineteve si dhe të gjithë te emëruarit nga ta.

1.4. Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive; dhe ai Zyrës së Kryeministrit; Kryeshefat e Agjencive të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër.

1.5. Drejtori, Zëvendës Drejtori dhe Drejtorët Regjional të Administratës Tatimore të Kosovës; Drejtori i përgjithshëm si dhe Drejtorët e Departamenteve të Doganës.

1.6. Auditorët në Zyrën e Auditorit Gjeneral dhe të gjithë auditorët e brendshëm te institucioneve

1.7. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor.

1.8. Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, anëtarët e Bordeve të Rregullatorëve, të Komisioneve apo Agjencive tjera të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër.

1.9. Anëtarët e Bordit, Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Bankës Qendrore.

1.10. Kryetarët dhe Zëvendës Kryetarët e Komunave, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale si dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale.

1.11. Anëtarët e Këshillit Gjyqësor, anëtarët e Këshillit Prokurorial, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, Auditori Gjyqësor, Prokurori Disiplinor.

1.12. Gjyqtarët dhe Prokurorët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Sekretari i Gjykatës Kushtetuese.

1.13. Drejtorët e të gjitha Departamenteve, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit publik në të gjitha institucionet publike.

1.14. Ambasadorët, Konsujt, Zëvendës Konsujt, Sekretarët e Ambasadave apo Konsullatave të Republikës së Kosovës.

1.15. Rektoret dhe Prorektorët e Universiteteve Publike, Dekanët dhe Prodekanët, si dhe Sekretarët e Universiteteve Publike dhe Njësive Akademike.

1.16. Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtoret dhe Drejtoret rajonal të Policisë së Kosovës, Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës.

1.17. Komandanti, Zëvendës Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

1.18. Drejtori, Zëvendës Drejtori si dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

1.19. Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij.

1.20. Kryeinspektorët dhe inspektorët e nivelit qendror dhe lokal.

2. Të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri si dhe Ministrat, e që nuk përmenden shprehimisht me këtë ligj.

Neni 5 Fushëveprimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për zyrtarët e lartë publik që gjatë ushtrimit të funksionit të parandalojnë konfliktin e interesit të tyre në mes të interesave publike dhe private, si dhe përcakton kufizimet bazë për zyrtarët e lartë publik për ushtrimin e funksionit publik dhe funksioneve tjera që nuk janë të natyrës publike.

Neni 6 Konflikti i interesit

Konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Neni 7 Parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit

1. Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për

mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar.

2. Zyrtari i lartë ushtron funksionin e tij në pajtim me ligjin dhe kodin e mirësjelljes.

3. Zyrtari i lartë duhet ta kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione.

4. Zyrtari i lartë përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të funksionit në të cilin është emëruar apo zgjedhur nga institucioni apo qytetarët.

5. Zyrtari i lartë nuk ka të drejt të shfrytëzojë funksionin publik për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjerët.

6. Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejt të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.

7. Zyrtari i lartë për punën që kryen në ushtrimin e funksionit nuk ka të drejt të pranojë apo kërkojë shpërblim tjetër përveç kompensimit që i lejohet në baze të dispozitave ligjore në fuqi.

8. Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

9. Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të veprojë me transparencë duke respektuar të drejtën e organeve përfaqësuese dhe të drejtën e qytetarëve që të informohen për veprimet e zyrtarit si personalitet publik.

Neni 8

Detyrimi i zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit

1. Zyrtari i lartë ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit.

2. Në rast se zyrtari i lartë është në dyshime për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës.

3. Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

4. Me rastin e marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me përbërjen e komisioneve për proceset tenderuese, drejtuesi i institucionit ose i autorizuari i tij duhet ta njoftoj

Agjencinë me shkrim, për anëtarët e atij komisioni, dhe agjencia ka të drejtë të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit në punën e atij komisioni.

5. Në rast se udhëheqësi apo institucioni udhëheqës nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe ai ka ose mund të ketë konflikt të interesit atëherë i drejtohet Agjencisë, për marrje të vendimit për rastin.

6. Zyrtarët udhëheqës të institucioneve, që nuk kanë udhëheqës të drejtpërdrejt për situatën e përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni i drejtohen Agjencisë.

Neni 9

Veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë

1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohen këto veprime:

1.1. të kërkojë apo pranojë shpërblim, premtim shpërblimi lidhur me veprimin e ndërmarr apo mosveprimin që është i obliguar ta ndërmerr në kuadër të ushtrimit të funksionit publik;

1.2. të fitojë ndonjë të drejt, apo të pranojë premtim për fitimin e saj, në rastet kur shkelet parimi i barabarësisë para ligjit;

1.3. të kërkojë, përvetësojë, pranojë, shpërblime apo shërbime për vete ose për tjetrin si kompensim të votës së tij në vendimmarrje;

1.4. të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit material personal apo personit në lidhje me të;

1.5. të pretojë punësim apo ndonjë të drejt tjetër në ndërrim për dhuratë apo dhuratë të premtuar;

1.6. të ndikojë në marrje - dhënie të punëve apo furnizimeve publike për përfitime personale;

1.7. të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm;

1.8. të ndikojë në vendimmarrje të organeve legjislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit personal apo të personave të afërt apo te besueshëm;

1.9. të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm;

1.10. të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik.

Neni 10

Ushtrimi i veprimtarive tjera nga zyrtari i lartë

1. Zyrtari i lartë i zgjedhur si përfaqësues i partisë politike ruan të drejtën e ushtrimit të funksionit në parti politike nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.
2. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.
3. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të realizojë fitime në bazë të drejtave të autorit, patentat dhe të drejtave të ngjashme.

Neni 11

Anëtarësia e zyrtarit të lartë në organizata joqeveritare

1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit, dhe të ngjashme.
2. Organizata joqeveritare me anëtar të organit drejtues nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të përfitoj mjete nga buxheti i Kosovës nëse anëtari i organit drejtues të organizatës joqeveritare, në cilësinë e zyrtarit, ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në vendimmarrje, me rastin e vendosjes për Organizatat Joqeveritare përfituese nga mjetet e buxhetit të Kosovës.

Neni 12

Tentimi dhe Ndikimi në vullnetin e zyrtarit të lartë

1. Nëse ekziston tentimi i ndikimit në vullnetin e ti, zyrtari i lartë publik duhet ta lajmëroj me shkrim udhëheqësin apo institucionin udhëheqës të organit që e ka zgjedhur apo emëruar në mënyrë që të mënjanohet çdo ndikim në vullnetin e ti.
2. Nëse ndaj zyrtarit të lartë gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejt apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të marr vendim konkret, tëri e njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrtimit do të vendos nëse ka nevojë të lajmërohen organet e ndjekjes.

3. Në rast tentimi apo ushtrimit të ndikimit për ta ndryshuar vullnetin e zyrtarit të lartë, zyrtari i lartë duhet :

3.1. të refuzojë ofertën;

3.2. të provojë identifikimin e ofertuesit nëse oferta është anonime;

3.3. nëse është fjala për dhuratë e cila për shkak të rrethanave nuk mund të kthehet, zyrtari i lartë duhet menjëherë ta njoftojë me shkrim dhe ta dorëzojë dhuratën të udhëheqësi mundësisht sa më shpejt, maksimalisht deri në pesë (5) ditë;

3.4. të tregojë dëshmitarët e ndodhisë nëse kjo është e mundur.

4. Nëse konstatohet se votimi dhe vendimi është në kundërshtim me vullnetin e zyrtarit të lartë, duhet të shpallet i pavlefshëm nga institucioni ku është nxjerr.

Neni 13

Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit të lartë

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3 . Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Neni 14

Transferimi i të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes

1. Personi, Zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t'i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimin të ndërmarrjes tek ndonjë person të besuar.

2. Personi Zyrtar i lartë, është i obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga zgjedhja, vendosja ose emërimi në detyrë me post zyrtar, të bëjë transferimin e të drejtave në udhëheqjen e ndërmarrjes në personin e besuar kurse brenda afatit prej pesë (5) ditë nga data e transferimit se këtyre të drejtave ta njoftoj me shkrim Agjencinë.

3. Personi i besuar nga paragrafi 1. i këtij neni do të veprojë në drejtim të realizimit të drejtave të zyrtarit të lartë dhe të drejtave nga kapitali në emër të tij por për llogari të zyrtarit.

4. Nëse personi i besuar krijon marrëdhënie afariste me institucionet e qeverisjes qendrore, lokale, ndërmarrjet publike apo me ndërmarrjet private ku kapitali i pronës publike ka më shumë se pesë (5)% të kapitalit apo aksioneve, është i detyruar që të njoftoj zyrtarin e lartë lidhur me marrëdhëniet e tilla afariste.

5. Gjatë kohës derisa të drejtat për administrim me ndërmarrjen i janë transferuar personit tjetër, zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të jap informata, udhëzime, urdhëresa apo në ndonjë mënyrë tjetër të qëndroj në lidhje me personin e besuar ashtu që të ketë ndikim në realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrave që dalin nga të drejtat e anëtarëve të ndërmarrjeve të tilla.

6. Zyrtari i lartë ka të drejtë të informohet për ecuritë dhe gjendjen në ndërmarrjen ku ka pronësi, ose pjesë të pronësisë.

7. Zyrtari i lartë ka të drejtë të rikthej të drejtat në administrimin apo menaxhimin e ndërmarrjes nga personi i besuar, kur sipas këtij ligji kushtet që diktuan këtë veprim nuk ekzistojnë më.

Neni 15

Mos pajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik

1. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private.

2. Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me prone publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme.

3. Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.

4. Zyrtari i lartë i cili ushtron veprimtari të pavarur në ndërmarrje apo veprimtari tjetër fitimprurës, është i detyruar të veproj në pajtim me dispozitat e këtij neni.

5. Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhi kontrate ose të përfitoj ndihme nga institucionet

qendrore ose lokale, ne te cilat zyrtari i lartë është ne pozite vendimmarrëse.

6. Nëse zyrtari i lartë bie në kundërshtim me paragrafin 5. të këtij neni, atëherë Agjencia duhet të kërkoj nga organi kompetent anulimin e kontratës me ndërmarrjen apo kthimin e çfarëdo përfitimi material të ndërmarrjes nga Institucioni ne të cilin zyrtari i lartë është ne pozitë vendimmarrëse.

Neni 16

Kufizimi i zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik

1. Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tille i dedikohet për shkak te funksionit.
2. Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Zyrtari i lartë publik nuk mund te ushtrojë ne mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë se saj.

Neni 17

Kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik

Zyrtari i lartë i cili përfundon ushtrimin e funksionit publik nuk ka të drejtë për një vit të punësohet ose të emërohet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve.

Neni 18

Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit te interesit

1. Procedura në Agjenci fillon zyrtarisht me kërkesën e zyrtarit të lartë dhe pas aprovimit nga udhëheqësi i tij.
2. Agjencia mund ta fillojë procedurën në bazë të lajmërimit të ndonjë personi tjetër apo lajmërimit anonim.
3. Agjencia e informon zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës dhe me kërkesën e tij e njofton me faktet qe posedon Agjencia.

4. Procedura e Agjencisë është konfidenciale. Agjencia i bën të njohura vetëm rezultatet përfundimtare të procedurës së zhvilluar.
5. Agjencia në rast të dyshimit të arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit do të njoftoj zyrtarin e lartë se ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara me këtë ligj.
6. Agjencia në mënyrë të pavarur i vërteton faktet, ndërsa institucionet tjera në kuadër të kompetencave të tyre janë të detyruara që pa shtyrje, sipas kërkesës së Agjencisë t'i vejnë në dispozicion faktet dhe të dhënat e kërkuara.
7. Nëse pas zgjedhjes, emërimit, ose konfirmimit të mandatit, personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej një aktivitet apo funksion që ky ligj e përcakton si të papajtueshëm me funksionin e ri, Agjencia e paralajmëron personin zyrtar të lartë dhe vendose një afat sipas të cilit atij do t'i kërkohej të ndërprejë aktivitetin apo të heqë dore nga posti.
8. Në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.
9. Organi kompetent ku personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej një aktivitet ose funksion të papajtueshëm me këtë ligj, duhet të filloj procedurën për shkarkimin nga funksioni sipas kërkesës së Agjencisë.
10. Kur deputeti i Kuvendit ushtron aktivitet të papajtueshëm me këtë ligj, Agjencia e njofton kryetarin e kuvendit, dhe kërkon fillimin e procedurave ndaj ti.
11. Agjencia brenda afatit të pacaktuar duhet të njoftohet nga organet kompetente për veprimet e tyre të ndërmarra.
12. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në web faqen zyrtare të Agjencisë.

Neni 19

Kompetencat e Agjencisë lidhur me konfliktin e interesit

1. Agjencia në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, kryen detyra dhe ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. drejtimin dhe përmirësimin e politikave dhe të mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave;
 - 1.2. ofrimin e ndihmës profesionale dhe teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore, të ndërmarra nga institucionet publike, për parandalimin e konfliktit të interesave;

1.3. ofrimin e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vlerësimin e projektligjeve që kanë të bëjnë me çështjen e konfliktit të interesave, kur kjo kërkohet nga ky institucion;

1.4. forcimin e kapaciteteve për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike;

1.5. këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçante, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave;

1.6. ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në tersi.

Neni 20

Sanksionet për shkeljet e dispozitave të këtij ligji

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuar si në vijim:

1.1. Për shkelje të nenit 8 paragrafët: 1., 2. dhe 6., nenit 9; nenit 11; nenit 12 paragrafët 1., 2. dhe 3. nën – paragrafët 3.1. dhe 3.3., nenit 13; nenit 14 paragrafët 1., 2. dhe 5.; nenit 15 paragrafët 1., 2. dhe 3., nenit 16 dhe nenit 17 të këtij ligji, zyrtari i lartë publik dënohet për kundërvajtje me gjobë nga pesëqind (500) deri dymijepesëqind (2500) Euro;

1.2. Për shkelje të nenit 14 paragrafët 3. dhe 4. si dhe nenit 15 paragrafi 5. të këtij ligji, personi i besuar dënohet për kundërvajtje me gjobë nga shtatëqind (700) Euro deri në dymijepesëqind (2.500) Euro;

1.3. Për shkelje të nenit 8 paragrafët 3., 4. dhe 5. të këtij ligji, udhëheqësi ose udhëheqësi i institucionit dënohet për kundërvajtje me gjobë nga njëmijë (1000) deri në dymijepesëqind (2.500) Euro.

2. Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mundë të shqiptojë edhe masën mbrojtëse: ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit

Neni 21
Mos përjashtimi i përgjegjësive tjera ligjore

1. Dispozitat e këtij ligji nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit të lartë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Çdoherë kur agjencia ka dyshim të arsyeshëm, se me shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ka elemente të ndonjë veprë penale, detyrohet që të paraqes kallëzimin penal në prokurorin kompetente.

Neni 22
Përgjegjësia për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji

Autoriteti qëndror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji është Agjencia.

Neni 23
Dispozitat e fundit dhe kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L - 133 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Ligji Nr. 03/L- 155 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-133 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-051
31 gusht 2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI